



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL

Nr. 2, datë 02.04.2026

**I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës që zhvillohet në sallën e Këshillit
Bashkiak**

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:20

Data e mbajtjes së mbledhjes : 02.04.2026

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Zëvendëskryetari i Bashkisë z.Gentian Kallmi si dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Denisa Luarasi: Përshëndetje,

Zëmë vendet..

Muka Ju lutem ...

Kastrioti të lutem. Kastrioti, Kastrioti.

Dorina Milja : A ulesh atje ?

Denisa Luarasi: Ju lutem...

Të nderuar këshilltarë ! I nderuar zëvendëskryetar! Të nderuar të pranishëm, media !

Deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës për Këshillin Bashkiak Durrës. Në këtë mbledhje do të shqyrtojmë dhe do të miratojmë projektvendime të propozuara nga kryetarja e bashkisë. Materialet ju janë vënë në dispozicion nga Sekretariati i Këshillit. Ftoj sekretaren të procedojë me thirrjen e emrave të këshilltarëve.

Dorina Milja: Përshëndetje ! Fillojmë...

Ardian Mukaderi tek.... Florian Tahiri...

39 këshilltarë në sallë.

V.O Hyn me vonesë në sallë këshilltarët: Klementina Meçi dhe Dritan Burgija. Del nga mbledhja Blerina Reçi. Gjithsej 41 këshilltarë në prezencë.

Denisa Luarasi: Faleminderit Dori.

Meqë kuorumi është i pranishëm, po vazhdojmë mbledhjen duke lexuar pikat e rendit të ditës.

Pika 1.	PËR ZGJEDHJEN E ZËVENDËSKRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK
Pika 2.	PËR RIALOKIMIN E FONDEVE TË RINDËRTIMIT TË PASHPENZUARA NË VITIN 2025, QË DO TË TRASHËGOHEN NË VITIN 2026
Pika 3.	PËR MIRATIMIN E FONDIT PËR PËRBALLIMIN E EFEKTIT FINANCIAR TË RRITJES SË PAGAVE PËR PUNONJËSIT E BASHKISË DHE INSTITUCIONEVE E NDËRMARRJEVE NË VARËSI TË SAJ
Pika 4.	PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË APARATIT TË BASHKISË SË DURRËSIT
Pika 5.	PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE TË BASHKISË SË DURRËSIT
Pika 6.	PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË POLICISË BASHKIAKE, DURRËS
Pika 7.	PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE PËR PUNONJËSIT E NDËRMARRJEVE DHE INSTITUCIONEVE NË VARËSI TË BASHKISË DURRËS
Pika 8.	PËR NGRITJEN, FUNKSIONIMIN DHE PËRBËRJEN E KËSHILLIT KULTUROR, ARTISTIK DHE SPORTIV PËR PERIUDHËN 2026-2028
Pika 9.	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN SHKURT 2026
Pika 10.	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN MARS 2026
Pika 11.	PËR MIRATIMIN E DHËNIES PËR ZHVILLIM TË PASURISË ME NR. 25/40, E LLOJIT “NDËRTESE”, ME SIPËRFAQE 410 M², NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 8518, RRUGA “PAVARËSIA”, LAGJJA NR. 13, DURRËS, ME QËLLIM SHKËMBIMIN NË NATYRË PËR PËRFITIMIN E SIPËRFAQES NDËRTIMORE EKUIVALENTE OSE MË TË MADHE SE OBJEKTI EKZISTUES
Ndërsa Pika 12 është informim për këshilltarët	INFORMACION NGA QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT MBI PROCEDURËN E DALJES JASHTË PËRDORIMIT/TJETËRSIMIT TË AKTIVEVE TË PANEVOJSHME TË INSTITUCIONEVE NË VARËSI TË SAJ

Keni ndonjë koment?

Jeni dakort me rendin e ditës?

Ardian Muka: Po, kryetar kam një koment. Po..

Denisa Luarasi: Po, Muka.

Ardian Muka: Mirëdita të gjithëve!

Meqënëse në pjesën e fundit neve kemi gjithmonë diskutime dhe pyetje nga komuniteti, besoj që edhe pranë Këshillit të Bashkisë ka ardhur një kërkesë për pjesëmarrjen për paraqitjen e çështjeve në mbledhjen e Këshillit Bashkiak nga ana e banorëve të projektit “TID”. Do kërkoja që në momentin që neve do jemi në pikën e fundit, pra që do jetë me pjesën e diskutimeve nga komuniteti, një kryesi, një numër banorësh, sikurse ato e kanë përcaktuar dhe kërkesën e tyre të jenë pjesë e mbledhjes, të futen në sallë dhe të jenë pjesë e mbledhjes dhe këtë duam që ta aprovojme bashkë qysh në këtë moment. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit Muka.

Kërkesa është administruar. Administrata ka përgatitur përgjigjet e pyetjeve, meqënëse në rend ditës ne nuk e kemi projektin “TID”, nënkryetari është përgatitur bashkë me mua si kryetare e këshillit për pikat që i përkasin Këshillit dhe do i përgjigjemi në pikën e diskutimit. Megjithatë..

Ardian Muka: I takon..i takon për procedurë, mbledhja është e hapur...

Denisa Luarasi: Tani zonja Entela Kojë ka qenë gjithmonë e pranishme. E kemi ftuar, por meqë e pamë të arsyeshme që në rendin e ditës nuk kemi pikë për “TID-in”, kemi menduar t’i kthejmë përgjigjet, dhe në faqen tonë të Facebookut mbledhja shfaqet online. Ajo mund ta ndjekë. Mediat janë, kështu që...

Ardian Muka: Besoj që ato kanë diçka në ndryshim nga hera e fundit që kanë qenë, ne s’duhet të humbim asgjë...

Denisa Luarasi: Tani ne....ju u larguat nga mbledhja. Ju u larguat nga mbledhja. Nuk ishit të pranishëm. Ne e ftuam zonjën Kojë. E keni ndjekur besoj nëpër media që mbledhja nuk shkoi ashtu siç duhet të shkonte në fakt. Kështu që kur të ketë pikë rendi dite për “TID-in”, patjetër që do jetë në sallë. Po, po...

Joniada Musaraj: Kryetare, të lutem...

Flutura Kasa: Meqënëse...

Joniada Musaraj: Atëherë Flutura, të lutem ...

Denisa Luarasi: Ja të dyja....

Joniada Musaraj: Vetëm një sekondë meqënëse e kërkoja.. Do flasësh para meje?

Flutura Kasa: Po

Joniada Musaraj: Okej, pastaj unë.

Flutura Kasa: Atëhere meqënëse dhe preke pak ti zonja kryetare largimin e opozitës, unë kisha vetëm diçka dhe s'du të ma marrin personale këtë që do flas, por u diskutua dhe herës tjetër dhe këtë radhë është pika e parë “Për zgjedhjen e zëvendëskryetarit të Këshillit Bashkiak”.

Nuk e njoh fare zonjën, kështu që nuk du të ma marri personale, por ajo as për respektin e emrit të vet nuk ndejti herës tjetër në mbledhje, kur do votohej emri i saj, sepse opozita tashi ja ka marrë dorën kësaj pune u largua. Në vend që të zgjidhte një përfaqësim me zbrit aty poshtë për të ndihmuar, meqëse po ja kishin marrë çunat dhe mos largoheshin të gjithëm, sepse ishin pika shumë të rëndësishme. Ndihma ekonomike, ishte 6% i qerasë, ishte dhe një pikë për gratë e dhunume. Domethënë tre pika shumë delikate që ato u larguan dhe pika tjetër propozimi nënkryetares së bashkisë. Domethënë katër pika ato u larguan.

Joniada Musaraj: Nënkyetares së Këshillit.

Flutura Kasa: Kështu që ne jse ç’rëndësi ka, hajde se e kupton ajo se çfarë dua të them unë.

Unë tashi nuk po kaloj nga ana ligjore se nuk i kam qejf këto neni kaq dhe aq. Nuk e di se nga cili grup këshilltarësh demokrat është propozuar zonja në fjalë. Aty na erdhi që është me firmën e zotit Burgija. Po zotin Burgija këto, më fal, a ta mbaroj unë të lutem?

Zotin Burgija këto e kanë ngri, e kanë futur në frigorifer. Tashi ta shkrijnë, ta marrin vesh se ku është. Kështu që unë i bëj thirrje këshilltareve socialiste, ashtu siç këshilltares demokrate treguan mungesë respekti dhe nuk votuan pro kandidaturës së Denisa Luarasit dhe Joniadës, atëherë edhe unë ju bëj thirrje që të votojnë kundër nënkryetares së këshillit bashkiak, kundër këtij propozimi. Tashi se sa më marrim parasysh këshilltares socialiste është në ndërgjegjen e tyre. Por llogjikisht nuk duhet të kenë të drejtë morale për ta ngrejt kartonin jeshil. Kushdoqoftë i kërkoj ndjesë zonjës në fjalë, kurrsesi mos të ma marri personale. Çdo lloj emri të ishte, këtë qëndrim do mbaja. Kështu që vota ime është kundër edhe e grupit të Partisë Socialdemokrate.

Dhe më fal edhe diçka të vogël kam. Meqënëse herës tjetër kam dalë në media si këshilltare e Partisë Socialiste, jam këshilltare dhe kryetare e Partisë Socialdemokrate. Dhe mos më bëni shumë reklamë se jam një çik e vjetër në moshë, nuk i baj shumë këto reklamat me u bë vipe tashi.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Kasa.

Po Joniada..

Joniada Musaraj: Atëherë përshëndetje të gjithëve.

Unë po e nis nga fundi i fjalës së zonjës Flutura. Zonja Flutura, rri e qetë dhe mos u shqetëso fare dhe për reklamën mediatike, ju dhe unë bashkë dhe të gjithë bashkë dhe një pjesë e atyre që fituan lirinë ditët e fundit, që u përjashtuan, ata kanë fituar liri. Në fakt u ka ardhur një i mirë po s'e kanë kuptuar akoma. Janë më afër qytetarëve sot më shumë se kurrë. Kështu që për këtë pjesë jemi të gjithë bashkarisht për qytetarët.

Në lidhje kryetare, në lidhje me kërkesën e zotit Muka, unë do doja nga ana juaj të mos lihet evazive. Kur ju thonë që nënkryetari i bashkisë dhe të gjithë në bashkë jemi përgatitur për t'i dhënë përgjigje, duhet të jeni pak më e prerë. Pra, o jemi pro, o jemi kundër. Dhe së dyti, doja që t'i jepet vlerë të njëjtat pyetje që kanë bërë qytetarët në rastin konkret për projektin “TID” kanë të njëjtën vlerë me pyetje që bën zoti Muka dhe në të tjerët bashkë kur jemi në mbledhje të tjera, kemi qenë

në mbledhje të tjera dhe kemi patur shkaqe të tjera dhe objekte të tjera diskutimi, kështu që të lutem të jemi më të qartë për këtë pikë. Faleminderit

Denisa Luarasi: Faleminderit,

Megjithëse ndoshta s'e ke dëgjuar, isha e prerë thashë jo nuk do futet në mbledhje...

Flutura Kasa : këto e ngrin Tan Burginë, por harrun këto që Tan Burgija është stërnip i Jakup Ferrës, kështu që mos i largoni shumë këto....

Denisa Luarasi: Po Muka ..

Ardian Muka: Po, atëherë vazhdoj të insistoј për pjesën e meqënëse mbledhjet e Bashkisë janë mbledhje të hapura dhe përderisa ka një shqetësim qytetar, në pikën ku neve mund t'i lejojmë diskutime dhe pyetje nga komuniteti, është mëse e ligjshme që ato të dëgjohen. Nuk e dimë çfarë problematika kanë, kanë qenë këtu mbledhjen e kaluar. Nuk ka asgjë të keqe të dëgjohen kur të vijë pika 12 apo 13, kush është pika e fundit, ata të jenë prezentë këtu. Dhe e shoh të jashtëligjshme mosprezencën e tyre me vendim.

Përsa i takon pjesës tjetër të largimeve që ju po supozoni, atë çfarë ndodh, në kampin e djathtë siç e tha dhe zonja parafolëse, mu bë qejfi që i priska në gjiun e saj, por të gjithë ata kanë thënë që do vazhdojnë dhe do jenë pjesë e grupit të djathtë. Nuk kanë një vendim akoma nuk është pranë Këshillit Bashkiak, në dijeninë time nuk ka ardhur asnjë vendim. Grupi vazhdon për momentin të jetë ashtu siç ka qenë. Ju faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Muka.

Atëhere vazhdojmë me rendin e ditës. Të lutem kush është pro do votojmë elektronikisht.

Kush është pro për rendin e ditës? Hap votimin.

Anisa Ibraj: O zonja kryetare e këshillit lutem ta them edhe një fjali meqë është shqetësuar për pjesën e familjeve 6% për ndihmën ekonomike.

Joniada Musaraj: Vazhdo Kryetare...

Denisa Luarasi: Të lutem kur të jetë te pika e rendit ditës.

Anisa Ibraj: Jo, jo po du ta them tani meqë se kemi votuar radhën e kaluar në qoftë se do shqetësoheshit kaq shumë për ato familje nuk do rrisnit rrogën e Kryetarit të Bashkisë tu i shku 3 milion lekë...

Denisa Luarasi: Me 40 vota pro miratohet rendi i ditës pa ndryshime.

- Përsa i përket **pikës 1** “Për zgjedhjen e zëvendëskryetarit të Këshillit Bashkiak” procedura e zgjedhjes do zhvillohet në mënyrë transparente.

Kemi një kërkesë për zonjën Mirela Shala. Meqënëse Partia Demokratike është grupi më i madh opozitar. Keni ndonjë kandidaturë tjetër përveç Mirela Shalës?Nuk keni.

Atëherë në mbështetje të nenit 55 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar jeni dakort ta zhvillojmë të hapur votimin?

Po. Je dakord për të hapur ?

Okej.

....*Nuk ka kundërshti në sallë.....*

Hekuran Markola: Kam dy fjalë, mos u shqetëso.

Denisa Luarasi: Jo apsolutisht.

Hekuran Markola: Faleminderit.

Atëherë meqë unë u bëra shkas në mbledhjen e kaluar që mos zgjidhet zëvendëskryetarja e Këshillit Bashkiak të opozitës dhe do të jap qëndrimin tim që ka qenë parimor aspak personal, për shkak se unë nuk mund të votoj kurrë kur s'është prezent një person që në thojnëza i japim pushtet, duke qenë se sot është prezent deklaroj votën time pro dhe të kuptoj që kjo ka qenë gjithçka parimore dhe sepse në fakt ne socialistët jemi mësuar gjithmonë t'ju zgjedhim kryetarët tyre, po s'ishte momenti besoj, kështu që deklaroj votën pro.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Markola.

Atëherë kalojmë votim për zëvendëskryetarin e Këshillit Bashkiak. Kush është...?

Me 29 vota pro miratohet. Emërohet zëvendëskryetare e Këshillit Bashkiak zonja Mirela Shala.

Dorina Milja : 29 pro, 6 abstenim dhe 5 kundër.

Denisa Luarasi: Ju uroj suksese dhe e ftoj që të vijë në kryesi.

Zëvendëskryetarja ka kërkuar fjalën.

Fol..vazhdo..

Mirela Shala: Okej. Atëhere të nderuar kolegë!

Falenderoj gjithsecilin prej jush që më dha besimin dhe përmes votës suaj u zgjodha nënkryetare. Gjithashtu respektoj mendimin e gjithkujt, është i hapur çdokush. Është nder dhe privilegj për mua t'i shërbej gjithkujt në këtë pozicion. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Suksese! Mirë se erdhe.

Flutura Kasa: Të shkoftë puna e mbarë. Po unë kam qejf kur ja them njerëzve në sy gjërat. Kështu që, për mua është në rregull. Çdo njeri tregoi atë të vetën, por mungesa e respektit ndaj të njëjtës gjini mua nuk më pëlqen.

Denisa Luarasi: Atëherë vazhdojmë me mbledhjen.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 2**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë kryetare, komisioni ynë pikën 2 e votoi me shumicë votash dhe ftojme Këshillin sot që ta miratojë. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Marsida Feshti.

Marsida Feshti: Përshëndetje!

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort që pika 2 të kalojë për votim në Këshill. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Feshti.

Komisioni i Buxhetit, Financës, Taksave-Tarifave, zoti Hekuran Markola.

Hekuran Markola: Faleminderit.

Meqënëse s'është kryetari sot mungon, atëherë Komisioni i Buxhetit, Financave, Taksave, Tarifave u mbledh dhe vendosi unanimisht që të kalojë për votim Këshillit Bashkiak pika 2 e rendit ditës.

Denisa Luarasi: Atëherë komente, pyetje kemi për pikën 2 të rendit ditës?

Muka ka kërkuar fjalën. Thërrite mikrofonin të lutem.

Po Muka. Muka mikrofonin.

Mund të flasësh me mikrofonin e kolegut?

Ardian Muka: Ok. Atëherë në lidhje me relacionin që na është përcjellë “Për rialokimin e fondit përfituar nga fondi i rindërtimit të buxhetit të shtetit pa shpenzuara në vitin 2025 dhe do trashëgohen në vitin 2026”, nga një lexim që kemi bërë, pra na rezultojnë që kemi fonde të mbetura nga viti 2024, që janë trashëguar në vitin 2025 për 1.12 miliard lekë ose rreth 11 milion euro. Në vitin 2025 janë konsumuar vetëm 404 milionë, pra rreth 4 milionë euro, ndërkohë që kërkojmë prapë shtesë në vitin 2025 për 320 milionë euro të tjera, pra për 3 milion euro të tjera. Ajo që unë dua të di nga ana e administratës, është që pse nuk arrijmë të përthithen këto fonde dhe neve shkojmë në rialokim nga viti në vit? Përderisa nuk janë konsumuar 24-ën, 25-ën, pse duhen rialokuar në 2026 këto fonde me po të njëjtin destinacion? Natyrisht, e dimë që ka objekte, të cilat janë në ndërtim e sipër, por për secilin prej tyre është e përcaktuar faza kur do fillojnë dhe kur ato duhet të mbarojnë dhe fondi shkon fiks për këtë periudhë. Pra nuk shoh ose më saktë dua shpjegim që pse këto fonde realokohen në 24-ën, 25-ën, 26-ën?

Një tjetër problematikë që ne e kemi ngritur, a mund të kemi një regjistër përfundimtar mbi objektet dhe shkallën e dëmtimit të tyre nga tërmeti i vitit 2019? Sepse jemi në vitin 2026, e kemi kërkuar dhe herë të tjera. Ne kemi kërkuar nga Bashkia të ngrejme dhe një komision hetimor, por që me prepotencë, me votën e të majtës, nuk na u dha kjo e drejtë dhe aty do kishim kuptuar dhe ndofta do ishim do ishim më të qartë se çfarë po ndodh me fondet e rindërtimit, sepse sot e kësaj dite na rezulton që vazhdojmë, japim fonde, riallojmë fonde nga viti në vit dhe ndërkohë kemi akoma shumë problematika përsa i takon pjesës së tërmetit. Gjithashtu një nga pyetjet që do bëja pavarësisht që nuk është pjesë këtu, por komuniteti e ka shumë problem, kur do futen banorët në

ndërtesat e reja, të cilat janë bërë me grantet e fondet Emirateve Arabe në zonën e Porto-Romanës, në zonën e Spitallës?
Ju faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Muka,
Nënkryetar.

Gentian Kallmi: Përshëndetje të gjithëve. Faleminderit dhe për pyetjen.

Në lidhje me projektvendimin numër 2, dua t'ju sqaroj se referuar ligjit të buxhetit, pjesa ekonomike e angazhuar për kontrata të lidhura dhe në proces, në përfundim të një viti ushtrimor, duke qenë se janë disa kontrata me shtrirje disa vjeçare, janë fonde të angazhuara për kontrata, të cilat vazhdojnë zbatimin dhe në vitin 2026. Siç e keni të detajuar edhe me objekte në relacion. Nga ana tjetër në lidhje me regjistrin përfundimtar, unë e mbajta shënim do të administrohet si kërkesë edhe do ju vëhet në dispozicion.

Në lidhje me strehimin në zonën e re për zhvillim në Spitallë, pjesa më e madhe e të gjithë përfituesit janë nëpër apartamentet e tyre, të cilëve janë dorëzuar çelësat. Jemi në fazën e fundit të shqyrtimit të dosjeve të fundit për të cilën do ju prezantojmë materialet për mbledhjen në Këshill Bashkiak.

Ardian Muka: Po thoni që janë brënda banorët ?

Gentian Kallmi: Po po. Pjesa që janë përfituese janë brenda.

Denisa Luarasi: Faleminderit nënkryetar. Atëherë kalojmë votim elektronik.

Me 39 vota pro 1 abstenim miratohet pika 2 e rendi i ditës pa ndryshime

- Kalojmë tek **pika 3**. I jepet fjala Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë dhe në lidhje me pikën 3, ne si komision u shprehëm dakord dhe jemi shumë të lumtur që dhe pikat në vijim që do vijnë sot në rendin e ditës kanë lidhje me rritje të pagave. Faleminderit

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.

E merr fjalën Komisioni i Buxhetit, Financës, Taksave-Tarifave, zoti Hekuran Markola.

Hekuran Markola: Faleminderit.

Edhe pika numër 3 e rendit të ditës kalon për votim në Këshillin Bashkiak.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Markola.

Komente ? Pyetje kemi për pikën 3 të rendit ditës?

Llesh Çuni : Ka unë një pyetje.

Denisa Luarasi: Po Çuni?

Llesh Çuni: Në mos gabohem arsimi parashkollor kopshtet, janë në varësi të Bashkisë. Teksa shoh projektvendimin nuk e lexoj si zë për rritje pagash. Është përfshirë te arsimi bazë? Është përfshirë në një zë tjetër? Thjesht këtë përgjigje desha. Është parashikuar rritje pagash për arsim parashkollor, edukatore të kopshteve?

Denisa Luarasi: Faleminderit.

Ftojme ndonjë nga administrata t'i kthejë përgjigje pyetjes së këshilltarit Llesh Çuni.

Nënkryetar do...?

Okej se s'punoka sinjali...

Gentian Kallmi: Po, është përfshirë dhe arsimi bazë.

Denisa Luarasi: Atëherë faleminderit nënkryetar.

Atëherë.. po, po Muka kërkoje fjalën.

Ardian Muka: Për vitin 2025 fondi i pagave për Bashkinë e Durrësit ka qenë 200, më fal 2 miliard e 15 milion 73.000 lekë, pra rreth 20 milion euro. Ndërkohë që kërkohet një shtesë për 213 milionë që janë rreth 2 milion euro ose më sakt 10 % e asaj çfarë ka qenë fondi i pagave për vitin 2025, për 2026. Nga relacioni, jepet shpjegim që këto janë thjesht rritje që bëhen për efekt të vjetërsisë në moshë, rritjes profesionale e të tjera. Do thoja që duke pasur parasysh me të gjithë problematikat që ka qyteti i Durrësit, një rritje e këtillë e parashikuar ndër të tjera dhe në projektbuxhetin dhe pastaj që u bë buxhet për 2026. Pra nuk del e qartë, nuk del e qartë që kush është. Do kuptoja një indeksim për pjesën e inflacionit, do kuptoja një rritje për kushtet ku ekonomia globale neve të gjithë përballemi, por në relacion nuk del e qartë. Del thjesht pjesa pra, që për rritjen e vjetërsisë në punë apo të të rritjeve profesionale që kanë pasur nuk besoj që onblok e gjithë administrata e bashkisë ka performuar më mirë, është rritur profesionalisht dhe të gjitha dhe meriton këtë rritje. Siç e thanë dhe parafolësit, besoj që thashë do kemi shumë problematika kemi ato 6%-at e famshëm dhe në qoftë se këto 2 milion që do kalonim atje do i jepnin një dorë atyre njerëzve që realisht janë në nevojë.

Unë vazhdoj ta përsëris dhe një vërejtje që kam, përderisa në mënyrë të tërthortë me rritjen e pagave të administratës së bashkisë, por kryesisht të kryetares së bashkisë, përcaktohet automatikisht edhe rroga e këshilltarëve bashkiakë. Unë këtë e shoh si një konflikt interesi. E kam ngritur dhe herë tjetër. Nuk më shkon pjesa që përderisa edhe parlamenti e bën kështu edhe neve do ta bëjmë kështu. Për mua këtu ka një përplasje ligjore. Shumë mirë

Denisa Luarasi: Është shpërblim Muka. Jo rrogë, këshilltarët kanë shpërblim.

Ardian Muka: Po flasim dhe shpërblim.

Denisa Luarasi: Jo, ta saktësojmë..

Ardian Muka: Prap, është prapë është konflikt interesi. Pra në momentin që ne përcaktojmë dhe i japim okein përcaktimit të të rrogës së kryetares, meqënëse 1/10 është shpërblim për këshilltarët,

automatikisht neve kemi përcaktuar shpërblimin tonë. Këtë e shoh. Po mund të jetë, mund të dalim me një vendim me VKM. Shumë mirë që rrogat e Bashkive të gradës së parë mund të jenë këto, të dytës kaq, në bazë të numrit të popullsisë.

Denisa Luarasi: Muka pak më i përmbledhur të lutem se..

Ardian Muka: Pra shoh që kjo rritje nga motivimi që ju keni dhënë është, nga arsyetimi që keni dhënë është e pamotivuar. Natyrisht do isha për rritjen e rrogave të mësuesve, të edukatorëve. Do isha për rritjen e rrogës së policisë bashkiake, por nuk shoh që pse duhet të rriten rrogat e administratës së mirëfilltë të Bashkisë.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit. Ne zbatojmë ligjin.

Atëherë kalojmë votim.....

Me 31 vota pro dhe 9 abstenim miratohet dhe pika 3 e rendit të ditës pa ndryshime

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 4**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë dhe në lidhje me pikën katër, komisioni ynë e votoi me shumicë votash dhe fton Këshillin ta miratojë sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.

Merr fjalën Komisioni i Buxhetit, Financës, Taksave-Tarifave, zoti Hekuran Markola.

Hekuran Markola: Edhe komisioni jonë e kaloi në unanimitet për votim në Këshillin Bashkiak.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Markola.

Komente? Pyetje ka për pikën 4 të rendit të ditës?

Prap, të lutem. Po Muka

Ardian Muka: Jo, thjesht doja të sqaroja që neve abstenuam, do vazhdojmë të abstenojmë deri tek pika 7, pra për të gjithë ato që kanë lidhje me në moral të asaj që neve kemi bërë edhe me projekt-buxhetin, buxhet tashmë ku kemi shprehur të gjithë observacionet tona. Thashë, jemi për rritjen e pagave të pjesës së administratës së ulët, të arsimtarëve, të pjesës së policisë bashkiake, të pjesës së administratorëve normal, ndërsa për rritjen e administratës së lartë nuk jemi dakort dhe do vazhdojmë ta deklarojmë votën tonë...

Denisa Luarasi: Okej, e kuptuam qëndrimin tuaj, jeni shumë i qartë.

Kalojmë në votim elektronik, faleminderit.....

Me 29 vota pro dhe 11 abstenim kalon dhe pika 4 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 5**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë meqënëse zoti Muka e ka ndarë mëndjen deri tek pika e 7, do bëj të njëjtën retorikë. Atëhere të them të drejtën s'kisha ndërmend të flisja, po zoti Muka e ka aftësinë që të më ngacmojë gjithmonë kur do herë interesin....

Denisa Luarasi: Jonada vazhdojmë pak shpejt të lutem...

Joniada Musaraj:dhe po them zoti Muka, që ju keni qenë ndër të parët që keni dashur gjithmonë rritje të pagave dhe të mos kuptosh ndryshimin e fytyrës së institucioneve, ndërmarrjeve në varësi të Bashkisë dhe të policis bashkiake si ka qenë dhe si është sot atëherë do të thotë që bashkë jemi totalisht në rrugë të ndryshme të kundërta. Kështu që unë do të ftoja ta rimendosh. Jemi tek pika e 5, rimendoje dhe njëherë pikën 5, 6, 7, që të japësh votën pro bashkarisht me grupin tuaj.

Kryetare ne me shumë dashamirësi si komision e kemi votuar pikën 5 dhe pikët në vijim për rritjen e pagave, kështu që ftoj Këshillin sot që të japi votën pro dhe tu japi atë që meriton gjithsecilit. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.

E merr fjalën Komisioni i Buxhetit, Financës, Taksave-Tarifave, zoti Hekuran Markola.

Hekuran Markola: Faleminderit.

Edhe për pikën 5, komisioni e dërgon për votim në Këshillin Bashkiak. Kalon.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Markola.

Komente ? Pyetje kemi për pikën 5 të rendit ditës ?

Po Muka.

Ardian Muka: Në përgjigje me thënë të drejtën edhe për atë vërejtje që bën zonja Musaraj, do thoja që,... vazhdoj ta them jemi për rritjen e rrogave të administratës së ulët. Nuk shohim asnjë motiv të rritjes së administratës lartë, sepse nuk na janë dhënë motivacionet që pse këto po bëhen. Me thënë të drejtën pastaj më vjen për të qesh kur dhe qytetarët durrsakë për këtë më janë dëshmitarë, kur në ditë të caktuara shohim që në bulevardin kryesor, por dhe në rrugë kryesore të Durrësit nga një polic bashkiak në krahun e majtë, një polic bashkiak në krahun e djathtë, ke të njëjtat viza dhe një polic bashkiak tjetër që merr njerëzit dhe i përcjell nga një krah ke krah tjetër. Kjo për mendimin tim është që ne po abuzojmë, bashkia abuzon me pjesën e pushtetit. Natyrisht ato policë po...

Denisa Luarasi: Nuk e sheh si përkujdesje për fëmijët kur kalojnë rrugën ?

Ardian Muka: E shoh si përkujdesje, por e shoh të ekzagjeruar përkujdesjen kur tre policë, tre policë për një vija të bardha dhe jo në një, por në të gjithë rrugën nga tre policë për vijat e bardha, kjo më duket tallje pastaj me fondet e qytetarëve.

Denisa Luarasi: Tani mos të dalim nga rendi i...

Okej, mirë. Faleminderit Muka.

Ardian Muka: Faleminderit.

Denisa Luarasi: Kalojmë votim elektronik.

Munir Konesha: 1 minut të lutem...

Denisa Luarasi: Po mirë, okej

Munir Konesha: Unë desha me sqaruar më shumë zotin Muka, se këtu nuk kemi të bëjmë me një rritje page, por me një indeksim të shkallës së inflacionit. Kështu që edhe atë merak t'ia heqim zotit Muka që vuan nga rritja e rrogave. Kështu që për të gjithë institucionet shqiptare që nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë. Në vitin 2026 janë indeksuar me 2.5%. Edhe sikur ne mos duam asnjëri, përsëri ato punonjës do ta marrin këtë rritje.

Denisa Luarasi: Kalojmë votim për pikën 5 të rendit ditës.

Me 29 vota pro dhe 11 abstenim kalon dhe pika 5 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 6**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë kryetare, komisioni ynë pikën 6 e votoj me shumicë votash dhe fton Këshillin të japi miratimin e tij.

Denisa Luarasi: Faleminderit.

E merr fjalën Komisioni i Buxhetit, Financës, Taksave- Tarifave, zoti Hekuran Markola.

Hekuran Markola: Edhe pika 6 kalon me shumicë votash për votim në Këshill Bashkiak.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Markola.

Komente, pyetje kemi për pikën 6 të rendit të ditës?

Okej. Kalojmë votim elektronik.

Me 29 vota pro dhe 11 abstenim kalon dhe pika 6 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 7**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë dhe për pikën 7 komisioni e votoj me shumicë votash dhe ftojme Këshillin ta miratojë sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.

E merr fjalën Komisioni i Buxhetit, Financës, Taksave- Tarifave, zoti Hekuran Markola.

Hekuran Markola: Pika 7 nga Komisioni i Buxhetit dhe Financave i kalon për votim Këshillit Bashkiak.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Markola.

Komente, pyetje ka për pikën 7?

Nuk ka. Kalojmë votim.

Me 30 vota pro dhe 10 abstenim kalon dhe pika 7 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 8**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë dhe pikën 8, ne e kaluam si komision dhe ftojme Këshillin të japi votën pro.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.

E merr fjalën Komisioni Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit, zoti Kastriot Xhongoli.

Kastrioti?

Kastriot Xhangoli: Përsëndetje.

Edhe për pikën 8, komisioni ynë ra dakord për ta kaluar në Këshill për votim. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit zoti Xhongoli.

Komente, pyetje kemi për pikën 8 të rendit i ditës?

Nuk ka. Kalojmë votim elektronik.

Me 40 vota pro, miratohet pika 8 e rendit të ditës.

Ju lutem qetësi në sallë.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 9**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë dhe pikën 9, ne si komision votuam pro, kështu që ftojme Këshillin ta miratojë sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.

Merr fjalën Komisioni i Barazisë Gjimore, Mirëqenies Sociale dhe Mosdiskriminimit zonja Eda..Edlira Shemsi.

Ju lutem thërrite mikrofoninnëse..

Edlira Shemsi: Pikë së pari dua të them për atë çfarë u diskutua më parë që ne abandonuam mbledhjen tjetër dhe nuk morëm pjesë në miratimin e ndihmës ekonomike...

Denisa Luarasi: Ju lutem mos më kalo nga...

Edlira Shemsi: Jo, jo, jo, ju lutem zonja kryetare ju lutem, unë në cilësinë e kryetares së këtij komisioni, relatova dhe thashë ne kemi kaluar në komision dhe ne jemi dakord, kalojeni dhe ju shumë mirë mund ta kishit kaluar nuk kishit asnjë pengesë as numra as pengesë...

Denisa Luarasi: Ju lutem kur ishte rendi ditës mund ta kishit marr fjalën dhe të kishit diskutuar..

Edlira Shemsi: Ju lutem nuk u kalua, sepse ju nuk deshët ta kalonit, për të treguar që ne nuk deshëm të miratonim ndihmën që nuk është fare e vërtetë, sepse unë ndejta vetë këtu në mbledhje dhe në cilësinë e kryetares së komisionit ia relatova këtij Këshilli.

Denisa Luarasi: Zonja jeni dakort me...

Edlira Shemsi: Tani, tani kthehemi tek pikat këtu.

Pasi u mblodhëm me shumicën e nevojshme, ne si komision diskutuam dhe njëherë, sepse ishte diskutuar dhe u ridiskutua ndihma ekonomike për familjet në nevojë brenda fondit limit 6% dhe fondeve të Bashkisë për muajin shkurt dhe u kalua kjo pikë dhe ia relatojmë Këshillit.

Denisa Luarasi: Faleminderit.

Komente ose pyetje kemi për pikën 9 të rendit të ditës?

Po. Thërrite mikrofonin. Po.

Anisa Ibraj: Meqë erdhi pika po them atë që doja të thoja në fillim.

Përderisa rriten pagat e kryetares së Bashkisë pa ato shpërblimet tona që në fakt nuk jemi fare dakord që të rriten shpërblimet tona. Duhet të kemi parasysh që të ndihmojmë dhe këto familjet në nevojë se është e turpshme sa paguhen ata. Në qoftë se më lejohet thjesht të përmend një nga këto familje këtu në relacionin që keni dërguar ju, Fatbardha Kasmi, familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 57.000 lekë të vjetra, familja Merita Hani 21.000 lekë të vjetra. Pra kjo është e turpshme të rritet rroga e kryetares së Bashkisë se ja kemi harruar dhe fytyrën se nuk vjen as në mbledhje. Për çfarë lodhet kjo kaq shumë? Për çfarë e rrit pagën, domethënë nuk e kuptoj. Është e turpshme të mos merret parasysh që familjen në nevojë ju e cilësoni që janë në nevojë shumë t'i mos...

Denisa Luarasi: Zonja Ibraj merrni pjesë në komision? Jeni prezent në komision? E keni ngritur zërin në komision?

Anisa Ibraj: Unë jam në komision tjetër...

Denisa Luarasi: A vini ju në komision ?

Anisa Ibraj: Nuk më vendosni dot mua para përgjegjësisë. E kupton? Ju jeni para përgjegjësisë dhe ju jeni në pushtet. Ne jemi opozitë dhe vetëm fjalën kemi.

Denisa Luarasi: Ngre zërin në komision...

Anisa Ibraj: Vetëm fjalën kemi dhe unë komision nuk jam më se e kam lënë komisionin për pamundësi, për pamundësi prezence. Ama unë nuk jam në atë komision. Meqë je bërë kryetare e këshillit duhet ta kesh parasysh që unë s'jam në komision...

Denisa Luarasi: Kalojmë votim.

Kush është pro për pikën 9 të rendit të ditës?

Me 40 vota pro miratohet dhe pika 9 e rendit të ditës

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 10**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë dhe pikën 10, ne e votuam me shumicë votash dhe ftojmë Këshillin ta miratojë sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.

E merr fjalën Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqenies Sociale dhe Mosdiskriminimit zonja Edlira Shemsi.

Të lutem thërrite...

Edlira Shemsi: Komisioni i Çështjeve Sociale Barazisë dhe Kundër Diskriminimit pasi mori me shumicë prezente në shqyrtim listën e familjeve në nevojë që marrin ndihmë ekonomike për muajin mars 2026, brenda fondit limit 6% dhe të ardhura të Bashkisë, e kaloi atë me shumicë dhe ja relatojmë Këshillit.

Në këtë pikë doja të them atë që në fakt e kam ngritur disa herë. E thashë dhe mbledhjen e fundit që kur u diskutua pika, që u relatua për t'u kaluar, që nuk u kalua për muajin shkurt, që në fakt duke qenë që dhe sot miratohen prapë pagat, këtu nuk bëhet asnjë lloj përçapim për të rritur ndihmën ekonomike. Në një vend që në fakt nuk është nxjerrë as minimumi etik, që duhet të nxirret, por edhe si bashki asnjë lloj iniciative, merret iniciativa për të rritur pagat e administratës, por për asnjë, për të rrit asnjë përqindje ato ndihmën ekonomike të këtyre familjeve në nevojë. Gjithsesi ne kemi kaluar këtë muaj mars dhe ja relatoj Këshillit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Edlira.

Komente, pyetje ka për pikën 10 të rendit të ditës? Nuk ka.

Kalojmë votim.

Me 40 vota pro miratohet dhe pika 10 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 11**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë dhe pikën 11 ne e miratuam dhe ftojmë Këshillin të japi votën pro.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.

E merr fjalën Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor zoti Hekuran Markola.

Hekuran Markola: Faleminderit,

Komisioni i Pronave Publike pas një sqarimi shterues nga përfaqësuesi i Bashkisë Drejtoresha Juridike, e kalojmë për votim në Këshillin Bashkiak.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Markola.

E merr fjalën Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës, zonja Jonada Mamo.

Jonada Mamo: Përshëndetje.

Edhe komisioni jonë e kalojë me shumicë votash.

Ftojme Këshillin ta votojë. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit zonja Mamo.

Komente, pyetje kemi për pikën 11 ?

Po Muka.

Ardian Muka: Siç e kemi diskutuar edhe në komision, unë, kemi dhënë okej që kjo çështje të trajtohet në Këshill, por me pjesën e refleksioneve që neve kemi paraqitur aty. Miratimi i dhënies që kërkohet të paktën në pjesën e relacionit për një sipërfaqe ndërtesë 410 m² ndodh në zonën katastrare 8518 rruga Pavarësia, pronë e Bashkisë Durrës. Del që kompania zhvilluese ka propozuar që në këmbim të këtyre 410 metrave të cilat banorët, më fal, pronarët e tokës mbi të cilët ngrihet kjo godinë nuk kanë preferuar që të bëjnë privatizimin. Në bazë të ligjeve në fuqi i lind e drejta Bashkisë së Durrësit të hyjë në një marrëdhënie PPP-je me zhvilluesin dhe me pronarët e tokës. Këtu doja të sqaroja një moment. Fakti që zhvilluesi ka propozuar 432.2 m² në këmbim të këtyre 410 metrave mund të duket si ofertë bujare, por duke pasur parasysh kushtet në të cilat ndodhemi dhe të drejtën që ligji i jep Bashkisë së Durrësit, unë do të preferoja dhe këtë e kam ngritur edhe në komision, që në tratativën që do bëhet me zhvilluesin sipas projektligjit nga ana e Bashkisë së Durrësit në pjesën pasi të ketë marrë lejen e ndërtimit do thoja lënë për mendimin tim, pjesë për hije dyshimi për abuzime dhe për të gjitha të tjerat. Do preferonim dhe këtë kam sugjeruar, që përqindja të kërkohet që në momentin e parë nga ana e Këshillit Bashkiak. Pra kur ne themi japim në këmbim jemi dakort për 410 metrat dhe neve duam të marrim 1,2,3,5, 10, 7% 20%-30% të asaj që do zhvillohet nga ana e zhvilluesit nga ana e ndërtuesit t'ja kërkonim që në këtë fazë. Natyrisht këtu mund të ketë një vakum, mund të ketë një vakum ligjor, por pyetja ime edhe për pjesën juridike të bashkisë është që kush është mekanizmi që ne do na garantojë që në momentin e dytë, pra pasi të dali leja e ndërtimit, do jemi të sigurtë që neve Bashkia do marrim atë çfarë na takon. Jemi dakort që 410 metrat të shprehet dhe të mos lëviz, por nuk duhet të kënaqemi me këtë. Meqënëse thashë mundësia e ligjit është pa shkelur të drejtat e pronarëve, sepse ato kanë të drejtën e shenjtë që të zhvillojnë pronën e tyre, por dhe Bashkia të marri dhe të optimizojë maksimumin e asaj çfarë është kjo pronë, e cila duhet thënë është pronë e amortizuar, është pronë e cila ka dalë nga nga fondi i përdorimit të ndërmarrjes që e zotëron, por nga ana e Bashkisë është pronë e Bashkisë. Kështu që, këtë do kërkoja që neve të ishim më konkret. Pra vendimi, në projektvendimin që do do kalojnë duhet të ishte shprehur që bashkia merr këtë përqindje dhe kjo duhet të ishte trajtuar më përpara. Teknikisht është e zgjidhshme, sepse ne duke pasur parasysh planin e përgjithshëm vendor, zona ku ndodhet kjo pronë 410m² i ka parametrat e përcaktuar. Pra, duke marrë si minimum këtë zhvillim, që propozuesi mund të sjelli, neve mund të kërkonim duke mbajtur gjithmonë prezupostin që 410 metrave neve duhet t'i marrim me patjetër si pronë të re, por kemi mundësinë që të marrim edhe më shumë. Meqënëse kjo pjesë është e paqartë, unë këtë e kam diskutuar edhe në komision, shpreh votën tonë kundër kësaj pike që keni sjellë në projektvendim. Jemi thashë për zhvillimin e pronës, jemi që Bashkia ta marri, por duhet përcaktuar shumë qartë dhe pastër ky moment. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Muka.

Kam ndonjë nga... Genti do i përgjigjesh?

Gentian Kallmi: Atëherë me sa kuptova ishte më shumë propozim sesa pyetje, por gjithsesi referuar projektvendimit numër 11, në titull përcaktohet që sipërfaqja nuk do të jetë më e vogël se sipërfaqja e objektit dhe do të jetë pjesë e marrëveshjes të lidhur nëpërmjet Bashkisë Durrës dhe investitorit. Gjithsesi të jeni të sigurt se Bashkia në Durrës, institucioni i Bashkisë do t'i ushtrojë funksionet e saj në mënyrë maksimizimin e sipërfaqes metrave katror, të cilët do i kalojnë Bashkisë. Është për të theksuar edhe që kjo godinë është në një truall privat, është jashtë funksionit dhe aktualisht është e pamundur që Bashkia të investojë në atë objekt, në rast opsioni investim nga ana e Bashkisë, sepse nuk mund të investojnë në një objekt të vetin me një truall privat.

Denisa Luarasi: Faleminderit nënkryetar.

Kalojmë në votim..

Të lutem.

Ardian Muka: Jam dakort me atë çfarë thotë nënkryetari. Dihet që Bashkia nuk ka interes për ta zhvilluar duke pasur parasysh që pastaj do hynte në një, nuk ka mundësi.. Por ajo që kërkoja është transparenca do ishte shumë më transparente ndaj qytetarëve që ne t'u shprehim që në këtë moment, kush do ishte në përqindje dhe jo tu lente evazive që do ngrehet një komision më mbropa, i cili do shkojë. Ky ishte sugjerimi im dhe për këtë thashë deklarova dhe votën. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Muka.

Kalojmë...Komente të tjera ka..? Nuk..

Po thërrite mikrofonin.

Po Markola ?

Hekuran Markola: Është shumë e qartë ajo që është bërë deri tani nga Bashkia. Ne e diskutuam dhe në komision që është e pamundur që përqindja të vihet në këtë fazë ku jemi. Përqindja përfitimit që mund të marrë bashkia për shkak se nuk ka leje ndërtimi dhe leje ndërtimi mund ta japë Bashkia në qoftë se është ndërtesë deri në gjashtë kate dhe mund ta japë KKRT-ja, a kush i jep lejet mbi 6 kate. Kështu që kur të vijë momenti dhe faza ajo është e qartë dhe Bashkia do ngrejë grup komisioni dhe do kërkojë maksimumin e mundshëm që mund të përfitojë nga kjo.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Markola.

Kalojmë votim.

Me 34 vota pro miratohet dhe 5 kundër. miratohet dhe pika 11 e rendit i ditës.

- Përsa i përket **pikës 12**, Qendra Ekonomike e Arsimit ka paraqitur një informacion mbi procedurën e daljes jashtë përdorimit, tjetërsimit të aktiveve të panevojshme të institucioneve në varësi të saj. Për këtë, relatton shefja e financës së Qendrës Ekonomike të Arsimit, zonja Megi Grami. Ftoj zonjën Grami të marrë fjalën.

Megi Grami: Përshëndetje, quhem Megi Grami. Jam përfaqësuese e Qendrës Ekonomike të Arsimit Durrës. Institucioni jonë ka për fokus pjesën e mirëmbajtjes dhe të administrimit të gjithë institucioneve paraarsimore, parauniversitare, kopshet, çerdhet, shkollat dhe konviktet.

Ideja e informacionit është për të nxjerrë në pah aktive që janë të panevojshme, që kanë të gjithë shkollat, të gjitha institucionet. Ne bazohemi te pjesa e dokumentacionit që na sjellin të gjithë drejtuesit e këtyre institucioneve. Bëjmë vlerësimin me normat përkatëse, me vitet e vënies në punë dhe titullari i qendrës time ka të drejtë në bazë të legjislacionit fuqi dhe udhëzimit numër 30 të ngrejë dy komisione, komisionin e vlerësimit dhe komisionin e nxjerrjes jashtë përdorimit. Të gjithë informacionin e duhur dhe me anën e vlerës financiare ndodhet pranë Qendrës Ekonomike.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit zonja Grami. Ishe shumë e qartë.

- Tani kalojmë **në diskutim**.

E ka kërkuar fjalën për diskutim zoti Ardian Muka.

Pyetje...pyetje për parkimin keni sjellë një pyetje?

Ardian Muka : Do e votojmë ?

Denisa Luarasi: Jo jo është informacion thjesht informacion.

.... Edlira Shemsi kërkon fjalën.....

Denisa Luarasi: Ja dhash fjalën Mukës për diskutim.... A ok mirë okej okej....

Po Edlira.

Edlira Shemsi: Meqë këtu kemi prezent edhe nënkryetarin e bashkisë unë dua t'i bëj pyetjen në lidhje me....

Denisa Luarasi: E keni administruar pyetjen përpara zonja Edlira?

Edlira Shemsi: Jo nuk e kam administruar.

Denisa Luarasi: Të lutem zbatoni rregulloren..

Edlira Shemsi: Mund të mos ma japi tani përgjigjen, por dua të bëj pyetje, të lutem të drejtën e pyetjes ne e kemi.

Denisa Luarasi: Po s'mund të jepet përgjigja, duhet përgatitur edhe nënkryetari. Po ç'janë këto..

Edlira Shemsi: Të lutem të drejtën e pyetjes ne e kemi

Denisa Luarasi: Okej, mirë vazhdo.

Edlira Shemsi: Në qoftë se përgjigjia nuk është e mundur të jepet, sigurisht do jepet me shkrim, do jepet me tjetër, por qëndron mbi një problematikë që është shumë sensitive. Mbi

dëmshpërblimin e qytetarëve të përmytur, të cilët kryesisht në zonën e ish kënetës, por edhe në zona të tjera të Durrësit, të cilat u përmytën tre herë, që në herën e dytë përmytja qenë goxha e konsiderueshme dhe ata morën borxhe e kredira, morën borxhe kredi për të rregulluar bizneset dhe banesat e tyre të dëmtuara. Ndërkohë ndodhi përmytja e tretë, e cila që vërtetë për një pjesë të banesave, por edhe të bizneseve të tyre që shkatërrimtare dhe ato ishin në pritje të bonusit që në përmytjen e dytë. Nuk kanë marrë akoma bonusin e përmytjes së dytë dhe jo më dëmshpërblimin e tanishëm. A ka një listë nga Bashkia për këto dhe a ka filluar të jepet dhe në qoftë se kanë filluar të jepen dëmshpërblime në bazë të çfarë prioritetesh?...

Denisa Luarasi: Ju lutem mos lëvizni nga salla, të respektojmë këshilltaren.

Edlira Shemsi: Domethënë është bërë një listë edhe janë dhënë prioritet për familjet që janë në gjendje ekonomike më të dobët të parave pastaj me radhë apo të gjithëve përnjëherë, sepse deri tani të gjithë ata qytetarët thonë që nuk kemi marrë asnjë lekë nga bashkia si dëmshpërblim për dëmet që pësuar nga përmytjat edhe në fakt një pjesë janë vërtet familje edhe në nevojë.

Denisa Luarasi: Je e qartë. Përgjigjen do ta marrësh herës tjetër.

Edlira Shemsi: Po, kurse sa për projektin “TID” që e tha zoti Muka, ata e kanë bërë kërkesën katër ditë para tek juve zonja kryetare, me numër protokolli edhe me email edhe duhet ishin prezent. Në bazë të ligjit të informimit ata duhet të ishin prezent dhe njëherë ata ia rrisin vlerat e këshillit që jemi prezent për varësi e qytetarëve.

Denisa Luarasi: Muka ?

Ardian Muka: Në kërkesën time që kam paraqitur me shkrim, doja një informacion nga ana e Bashkisë, meqënëse nga ana e Këshillit Bashkiak janë aprovuar parkimet me pagesë si ato në zonat e përcaktuara si parkime të grupuara, ashtu dhe ato në rrugët kryesore të qytetit si dhe parkimet rezidenciale të shtrira në gjithë qytetin e Durrësit. Ky projektvendim është bërë vendim ka kaluar që në vitin 2024 kur ne e kemi aprovuar jemi në 2026, dhe pyetja ime është : Përse akoma nuk ka filluar zbatimi i parkimeve me pagesë në qytetin e Durrësit? Si pika e parë, si pikë e dytë po në kuadrin e kësaj, kisha parkimin pranë Stacionit të Trenit ka filluar operimin e tij. Ka disa ankesa me thënë të drejtën nga ana e banorëve, unë jam banor edhe i asaj zone aty. Përsa i takon tarifimit, tarifimi është bërë nga ana e bashkisë apo nga ana e investitorit AADF, i cili ka ndihmuar në ndërtimin e saj? Doja thjesht një informacion dhe për këtë. Faleminderit.

Gentian Kallmi: Atëherë në lidhje me pyetjen mbi ecurinë e parkingjeve publike të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak numër 66 të 25 qershor 2024 ndër të tjerë janë miratuar përveç rrugëve me pagesë edhe shesheve e destinuar parkim në rrugë, si dhe zonat e reja të destinuara për parkim pagesë në sheshe, sipas tre shesheve.

Referuar shesheve bashkia pas miratimit të vendimit të Këshillit Bashkiak ka vazhduar me procedurat ligjore të prokurimit publik për vendosjen e trarëve të parkimit nga operator privat të licencuar. Aktualisht është përfunduar vendosja e trarëve. Në vazhdim gjithmonë në lidhje me sheshet është, ka përfunduar një material nga grupi i punës për një thirrje publike të bankave të

nivelit të dytë për të ofruar shërbimin e poshtë, pagesa me kartë bankare. Kanë, ka përfunduar thirrja dhe janë paraqitur ofertat nga bankat e nivelit të dytë për të përzgjedhur ofertën më të suksesshme dhe më të leverditshme.

Në lidhje me parkingjet në rrugë, pas miratimit të vendimit të Këshillit Bashkiak u ngrit një grup pune për të administruar dhe për të vlerësuar numrat e vendparkimeve. Në vitin 2025 është përcaktuar për buxhetin e vitit 2026 një fond për sinjalistikën e vendosjes të vijëzimeve dhe vendosjes së tabelave. Ndërkohë ka përfunduar në vitin 2025 sipas procedurave ligjore dhe marrëveshja me dy operatorë të telefonisë mobile, të cilët do ofrojnë *softwerin* dhe shërbimin për arkëtimin e vlerat pagesës së qytetarëve nëpërmjet shërbimit SMS.

Kjo është situata aktuale. Jemi në përfundim dhe shumë shpejt do zhvillojmë procedurën e prokurimit për sinjalistikën e nevojshme.

Ardian Muka: Ka shkuar dy vjet, prandaj them....

Gentian Kallmi: Pas miratimit të vendimit të Këshillit. Vendimi i Këshillit i hap rrugë të gjitha. Marrëveshja me operatorët nuk është e lehtë. Sinjalistika nuk është e lehtë. Vendosja e trarëve të parkimit kërkon afatet e veta ligjore dhe në përfundim edhe përzgjedhja e bankës së nivelit të dytë ka kohën e vetë mbas legjislacionit fuqi.

Denisa Luarasi: Faleminderit nënkryetar.

Ardian Muka: Në fakt Stacionin i Trenit është ai që ka përcaktuar Këshilli apo është....?

Gentian Kallmi: Atëhere, përse i përket parkingut, ndërtesës së parkimit publik, janë tarifat të cilat janë miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak.

Ardian Muka: Dhe për dijeninë tuaj gjithmonë administrimi, pastaj i këtyre si shesheve ashtu pjesës së rrugëve parkimeve me pagesë do vazhdoj të mbeten në administrimin e Bashkisë?

Gentian Kallmi: Po, po.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti nënkryetar.

Ka kërkuar fjalën për diskutim dhe zoti Jonuz Myshketa, po nuk ndodhet në sallë. Mungon, përgjigjen e merr herës tjetër.

Në postën elektronike të Këshillit zonja Entela Koja ka paraqitur pesë pyetje të cilat siç e thamë dhe në fillim të mbledhjes përgjigjet janë përgatitur nga stafi nga administrata. Po fillojmë me leximin e pyetjeve ku nënkryetari do i përgjigjet pyetjeve të bëra prej saj.

Përse pas takimit me kryetaren e bashkisë ende nuk është paraqitur një zgjidhje konkrete për qytetarët? Vazhdon pyetja një, ka katër pyetje brenda. Pse procesi vijon të zhvillohet pa transparencë duke trajtuar rastet në mënyrë individuale dhe jo në mënyrë të hapur për të gjithë? Si po merret në shqyrtim në mënyrë institucionale trajtimi i rasteve ku janë konstatuar gabime, pasaktësi dhe parregullësi në projekt dhe cilat janë mekanizmat e përdorur nga bashkia për korrigjimin dhe zgjidhjen e këtyre problematikave?

Nënkryetar, do t'i përgjigjesh pyetjeve apo t'i lexoj të gjitha?

Gentian Kallmi: Një nga një.

Denisa Luarasi: Okej, një nga një.

Gentian Kallmi: Atëherë, faleminderit. Referuar pyetjes së parë, unë dua t'ju sqaroj se Bashkia e Durrës ka një rol koordinator dhe gjithashtu pas detyrave të lëna në takimin e zhvilluar edhe me prezencën e Kryeministrit është kërkuar ngritja e grupit ndërinstitucional të punës për vlerësimin e objekteve që preken nga zbatimi i projektit “TID”. Ky grup normalisht përbëhet nga specialistë të fushës dhe nënpunës nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia e Zhvillimit të Territorit si dhe Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sporteve. Kjo e fundit për të vlerësuar siç u diskutua në mbledhje dhe monumentet e kulturës. Gjatë kësaj kohe Bashkia ka mbledhur të dhënat dhe ka zhvilluar takime me qytetarët që preken nga ky investim, sepse jo çdo qytetar ka të njëjtat problematika. Çdo dokumentacion është administruar dhe është përditësuar rast pas rasti në bazë të ligjit për arkivat. Ky dokumentacion do të shqyrtohet dhe do të plotësohet nëse do jetë e nevojshme nga grupi ndërinstitucional i ngritur dhe në fund të procesit administrativ të shqyrtimit të konkluzionit, grupi do dali me konkluzionet përkatëse rast pas rasti.

Denisa Luarasi: Faleminderit. Pyetja e dytë.

Duke qenë se është paraqitur një kërkesë e firmosur nga 75 qytetarë për pezullimin e vendimeve për prishjen e objekteve nga Bashkia Durrës dhe IMT, pse nuk është marrë ende një shqyrtim? Pse nuk është marrë ende në shqyrtim kjo kërkesë?

Gentian Kallmi: Atëherë referuar pyetjes dy, dua t'ju sqaroj se nuk është e vërtetë që ka një vendim prishje për këto objekte. Ka një Inspektoriat i Mbrojtjes së Territorit pranë Bashkisë Durrës ka vijuar me njoftimin për lirim vullnetar, por nuk ka një vendim për prishjet të objekteve.

Denisa Luarasi: Faleminderit.

Pyetja e tretë. Përse pas takimit me Kryetarin e Bashkisë dhe Kryeministrin nuk janë diskutuar me banorët alternativat e propozuara në atë takim?

Gentian Kallmi: Atëherë siç u citua dhe në përgjigjen e pyetjes një, gjatë takimit të zhvilluar me datën 14 shkurt 2026 sipas detyrave të lëna nga ky takim do të administrohen të gjitha kërkesat e banorëve dhe të gjitha institucionet e përfshira në grupin ndërinstitucional të punës do të analizojnë çdo kërkesë dhe shqetësim të parashtruar nga banorët, që preken nga zbatimi i projektit “TID”. Do verifikohet dokumentacioni ligjor i familjeve që posedojnë pronën, por nuk kanë kryer procedurat e regjistrimit pranë ASHK-së. Do rishikohen vlerat e trashëgimisë kulturore sipas raportit të specialistëve përkatës për disa objekte të veçanta dhe do rishikohen dhe vlerat e shpronësimit në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe gjithashtu dhe çështjet që lidhen me strehimin. Jemi akoma në proces.

Denisa Luarasi: Pyetja katër. Përse nuk po pranohet nisma për ngritjen e një komisioni hetimor dhe pse po ushtrohet presion ndaj anëtarëve që kanë firmosur për këtë nismë me qëllim tërheqjen e tyre?

Për këtë pyetje po përgjigjem unë si kryetare e Këshillit. Kërkesa, nisma është administruar, por numri i këshilltarëve mbështetës rezulton më i ulët se minimumi i kërkuar nga rregullorja. Pra, 1/4 e këshilltarëve nuk plotësohet.

Pyetja e pestë. Kurse pjesa tjetër më duket pak pyetje...ushtrohet presion? Nuk di si të përgjigjem. Pyetja e pestë. A keni dijeni si Këshill Bashkiak që nuk keni ushtruar një nga kompetencat themelore për këtë proces? Konkretisht miratimin e hapjes së nismës për hartimin e PDV-së për projektin Durrës. Meqë është një pyetje për Këshillin, por është më specifik, kërkoj ndihmën e nënkryetarit.

Gentian Kallmi: Po, atëherë në lidhje me pyetjen 5, dua t'ju informoj sepse plani rregullues i zonës që preket nga zbatimi i projektit "TID", nuk është një zonë që ka nevojë për PDV. Gjithashtu dua të theksoj se PDV i paraprinë lejes së zhvillimit. Leje zhvillimi e cila jepet nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, e cila nuk kanë nevojë për miratimin e PDV-së, po del, pasi për çdo leje dalin me një rregullore të veçantë në bazë legjislationit fuqi.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit nënkryetar.

Në fakt ka kërkuar dhe zoti Altin Xhogu të marri pjesë në mbledhjen e sotme për të diskutuar një problematikë, por nuk ka specifikuar sipas rregullores problematikën që administrata të përgatitet. do t'i kthejmë një përgjigje që të na e administrojë problematikën, të përgatiten dhe t'i kthejmë përgjigjen e duhur.

Atëherë duke ju falenderuar, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Faleminderit.

Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 22 (njëzet e dy) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga kryetari i këshillit, sekretari i këshillit dhe 3(tre) këshilltarë.

Mbajtësi i procesverbalit: Nikol Muka

Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :

Drejtues i seancës (Zv/kryetar i Këshillit Bashkiak) :

DENISA LUARASI

Sekretar i Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Këshilltar (Zv/kryetar i Këshillit Bashkiak) :

MIRELA SHALA

Këshilltar (Kr. Grupi) :

DRITAN BURGIJA

Këshilltar (Kr. Grupi) :

FLORIAN TAHIRI